03 / 2018

# pontes



Convivium

**HABITAT**

Inter Nos

**Prospectus**

TAKE A BREAK

**LINKING WORDS**

ALUMNI SPOTLIGHT

LIMITED EDITION

**2039** **studenti iscritti**
*studentë të regjistruar*

**studenti stranieri** **469**
*studentë të huaj*

**1511** **laureati**
*të diplomuar*

**professori** **599**
*pedagogë*

**6** **anni di accreditamento**
istituzionale da ASCAL e QAA
***vite akreditim***
*institucional nga ASCAL e QAA*

**205** **postazioni di studio**
in una biblioteca moderna
***vende studimi***
*në një bibliotekë moderne*

**laboratori** **8**
di supporto al processo didattico
***laboratorë***
*në mbështetje të proçesit didaktik*

**campus** **70.000m²**
immerso nel verde
***kampus universitar***
*rrethuar me gjelbërim*

*Pubblicato dalla*
**Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio**

*A cura di:*
Padre Daniele **Bertoldi**
Presidente della Fondazione
Nostra Signora del Buon Consiglio

Prof. Bruno **Giardina**
Magnifico Rettore dell'Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio"

*Un'idea di // Një ide nga:*
dott.ssa Daniela **Kostandini**
dott.ssa Diana **Hila**
arch. Elva **Margariti**
dott.ssa Enilsa **Magjistari**

*Grafica di // Përpunimi grafik*
arch. Samuela **Hidri**

*Botim i*
**Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë**

*Nën kujdesin e:*
Atë Daniele **Bertoldi**
President i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë

Prof. Bruno **Giardina**
Rektor i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"

# Editoriale // Editorial

## PONTES, NON MURI



*Magnifico Rettore*
*Prof. Bruno Giardina*

L'università Cattolica NSBC, è una Università albanese che rilascia diplomi di laurea doppi o congiunti con Università italiane. Siamo, e lo dico senza falsa modestia, un esempio unico di struttura universitaria in cui studenti albanesi, studenti italiani, professori italiani, professori albanesi si incontrano, si mescolano dando origine ad un processo formativo con caratteristiche specifiche, peculiari e difficilmente imitabili. Da noi si incontrano persone che non si sarebbero mai incontrate, nascono amicizie profonde che possono portare non prevedibili sviluppi sia sul piano personale che sociale. La Cultura, quella vera, non ha confini ed è il vero patrimonio dell'Umanità. Desideriamo far capire ai nostri giovani, ai nostri figli che ciascuno di loro è portatore di valori che devono essere messi a disposizione degli altri, che devono diventare patrimonio comune stimolando una evoluzione culturale senza confini. È per questo che abbiamo fortemente voluto far nascere questa rivista. Perchè nonostante la potenza del web, la carta stampata mantiene inalterati il suo fascino e la sua capacità di raggiungere finanche gli angoli più remoti, che restano inevitabilmente tagliati fuori dall'odierno mondo interconnesso grazie ad internet. Pontes vuole essere un veicolo per la Cultura, quella propriamente detta, che abbatte i confini e che si dà e si riceve in uno spirito di crescita comune. Pontes vuole essere un mezzo di comunicazione interna ed esterna, un ulteriore strumento di interazione tra Albania e Italia e tra Albania e i diversi paesi della comunità europea.
Buona lettura!

## PONTES, JO MURE

Universiteti Katolik ZKM është një universitet shqiptar që lëshon diploma të dyfishta ose të përbashkëta me universitetet italiane. Jemi, dhe e pohoj pa modesti të tepërt, një shembull unik universitar ku studentë shqiptarë, studentë italianë, profesorë italianë, profesorë shqiptarë takohen dhe bashkëveprojnë duke krijuar një proçes edukues me karakteristika specifike, të veçanta dhe shumë të vështira për t'u imituar. Tek ne takohen njerëz që kurrë nuk do të ishin takuar, lindin miqësi të thella që çojnë në zhvillime të paparashikueshme si në aspektin personal, ashtu edhe në atë shoqëror. Kultura e vërtetë nuk ka kufij dhe është pasuria e vërtetë e njerëzimit. Duam t'u përcjellim të rinjve, fëmijëve tanë, mesazhin se cilido prej tyre është mbartës i vlerave, që duhet të vihen në dispozicion të të tjerëve, e të bëhen pasuri e përbashkët për të nxitur një zhvillim kulturor pa kufij. Ja pse kemi dashur aq shumë të krijojmë këtë revistë. Edhe pse web-i është sot shumë i fuqishëm, letra e shtypur ka bukuri të pandryshueshme dhe aftësinë për të arritur edhe skajet më të largëta, që mbeten të izoluara nga bota e sotme, e ndërlidhur falë internetit. Pontes do të jetë një mjet për kulturën, atë që përmbys kufijtë dhe që shkëmbehet për t'u "rritur" bashkarisht. Pontes synon të jetë një mjet komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm, një tjetër instrument bashkëveprimi mes Shqipërisë dhe Italisë, si edhe mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Bashkimit Europian.
Lexim të mbarë!

# Sommario
## përmbajtja


**3**
Editoriale // Editorial

**5**
Cos'è Pontes?// Çfarë është Pontes?

**7**
Alumni spotlight
*Ilvi Begolli*

**9**
Take a break
*Combattere lo stress con il cibo // Si të luftosh stresin përmes ushqimit*

**10**
CONVIVIUM
*Una testimonianza di Giuseppe Russo // Një rrëfim nga Giuseppe Russo*

**11**
Prospectus
*De architectura*

**12**
Inter Nos
*Ernesto Alicicco*

**14-15**
Intervista con il Presidente della Fondazione NSBC// Intervistë e Presidentit të Fondacionit ZKM

**17**
Fatti e persone// Ngjarje dhe personazhe

**19**
IN&OUT
*Eventi// Evente*

**21**
Linking words

**22**
HABITAT
*La bacheca dei suggerimenti// Vitrina e sugjerimeve*




# Cos'è ?// Çfarë është? Pontes

La creazione e la realizzazione della rivista "Pontes" ha richiesto tempo e lavoro di squadra, ma il desiderio di presentare un modello, motivo d'orgoglio, e un'immagine completa dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" era molto forte.
La rivista prende il nome dal latino, "Pontes" - Ponti, e propone agli studenti, ai docenti e agli interessati diversi punti di vista dell'Università.
"Pontes" rappresenta il concetto di collegamento e di scambio tra diverse culture (albanese e internazionali). Le fondamenta sulle quali si basa la linea editoriale della rivista Pontes sono Amicizia – Rispetto – Uguaglianza – Valori – Coinvolgimento - Diversità – Solidarietà. Pontes è stata creata ed è nata per portare una luce di novità!

Krijimi dhe realizimi i revistës "Pontes" kërkoi kohë dhe bashkëpunim në grup. Dëshira për të prezantuar një model krenarie, si dhe imazhin akoma më të plotë të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", ishte e madhe.
Revista e merr emrin nga latinishtja, Pontes ~ Urat, dhe vjen për studentët, docentët dhe të interesuarit si një këndvështrim alternativ i universitetit tonë.
"Pontes" përfaqëson konceptin e urave lidhëse mes kulturave (shqiptare dhe ndërkombëtare). Kjo revistë do të informojë mbi situatat më të reja brenda universitetit dhe fondacionit, nismat, konferencat dhe aktivitetet promovuese. Themelet mbi të cilat bazohet linja editoriale e revistës janë miqësia - respekti - barazia - vlerat - gjithpërfshirja - diversiteti – solidariteti.
Pontes u krijua dhe lindi për të sjellë një këndvështrim të ri!

# Una Laurea Europea all'UCNSBC// Diploma Europiane në UKZKM



L'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" rilascia in virtù degli accordi presi con le Università italiane partners, diplomi di laurea che hanno la stessa validità di quelle italiani.
Joint e Double Degree, è quindi laurea congiunta o doppia, che porta con sé il grande valore aggiunto di un titolo un domani spendibile sia in Albania che in Italia e quindi di rimando in Europa.

- *Lauree congiunte e doppie con le Università pubbliche italiane*
- *Corsi di laurea accreditati in Albania e Italia*
- *Didattica di qualità e corrispondente agli standard europei*
- *Staff accademico qualificato italiano e albanese*
- *Opportunità di stage ed esercitazioni in Italia*
- *Opportunità di lavoro anche nei paesi dell'Unione Europea.*

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në bazë të marrëveshjeve me universitetet partnere publike italiane lëshon diploma, të cilat kanë të njëjtën vlefshmëri me ato italiane.
Joint e Double Degree, pra diplomë e përbashkët ose e dyfishtë e njohur në Shqipëri, në Itali dhe rrjedhimisht në Europë.

- *Diploma të përbashkëta dhe të dyfishta me Universitete publike italiane*
- *Programe studimi të akredituara në Shqipëri dhe Itali*
- *Didaktikë cilësore dhe me standarte europiane*
- *Staf akademik i kualifikuar italian dhe shqiptar*
- *Mundësi për të zhvilluar praktika mësimore në Itali*
- *Mundësi punësimi edhe në Bashkimin Europian.*

# ALUMNI spotlight

## *Ilvi Begolli*




Il successo diventa raggiungibile quando la formazione nutre il talento, quando i professori ti incoraggiano, ti stimolano e ti svelano i segreti della professione.
Ilvi Begolli, ex studente di Fisioterapia, presso l'UCNSBC ha ormai attraversato questi passaggi ed oggi è uno dei più noti fisioterapisti in Albania e anche il rappresentante UEFA per il corso "UEFA Football Education Doctor". Ex fisioterapista della Nazionale Albanese del Calcio U21 per 4 anni, oggi dirige il suo centro di fisioterapia, lavorando principalmente in ortopedia e post-trauma, e inoltre ha assunto altri studenti dell'UCNSBC: "Questi fisioterapisti sono i più preparati, avendo a disposizione una vasta scelta di testi e la didattica dei migliori professori". Ci racconta inoltre che la laurea gli è servita anche all'estero, poiché ha lavorato per un periodo in un centro di riabilitazione a Roma.
Delle esperienze che lo legano all'UCNSBC, Ilvi menziona il vantaggio di aver lavorato per cinque anni con il docente e rinomato medico italiano Ernesto Alicicco.
Il 32-enne collabora anche con diverse squadre nazionali e per varie discipline sportive.




Suksesi arrihet kur edukimi të ushqen talentin, të jep drejtimin për jetën, ndërsa profesorët të japin kurajon, nxitjen dhe të tregojnë sekretet e profesionit.
Ilvi Begolli, ish student i Fizioterapisë, pranë UKZKM-së i ka përshkuar tashmë këto faza dhe sot është një ndër fizioterapistët më të mirë në Shqipëri. Ai është përfaqësues i UEFA-s për programin e quajtur "UEFA Football Education Doctor".
Ish fizioterapist në Kombëtaren U21 të Futbollit për 4 vjet, sot drejton qendrën e tij, me fokus në ortopedi dhe post trauma, si dhe ku ka punësuar studentë nga UKZKM. "Këta fizioterapistë janë më të përgatiturit, sepse kanë në dispozicion literaturën, metodikën didaktike dhe pedagogët më të mirë". Ai rrëfen se diploma i shërbeu edhe jashtë Shqipërisë, pasi për një periudhë punoi në një qendër rehabilitimi në Romë.
Nga eksperiencat që e lidhin me UKZKM-në, Ilvi veçon përvojën 5 vjeçare të punës me pedagogun dhe mjekun e njohur italian Ernesto Alicicco.
32 vjeçari, sot ka edhe kontrata pune dhe bashkëpunimi me ekipe kombëtare dhe të disiplinave të ndryshme sportive.

# Dedicato alla salute//
# Përkushtuar shëndetit




Il Poliambulatorio "Padre Luigi Monti", la prima struttura fondata dalla Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio, opera in Albania da più di 20 anni e offre un'ampia gamma di servizi.

Localizzato nel centro di Tirana e ultimamente ristrutturato, il Poliambulatorio vanta uno staff medico qualificato che opera in diverse specialità come: Medicina Interna, Cardiologia, Oncologia, Dermatologia, Pediatria, Ortopedia, Ginecologia, Oculistica, Nefrologia, Chirurgia Digestiva. Insieme al Laboratorio Analisi, al settore di diagnostica per immagini e la Farmacia IDI-al, il Poliambulatorio rappresenta una delle eccellenze del settore. Alla gamma dei servizi è stato ultimamente aggiunto il nuovo servizio di Day Surgery – interventi chirurgici realizzati in giornata. Il Poliambulatorio è legato alla Clinica Odontoiatrica e quella di Fisioterapia (situate presso il campus dell'Università Cattolica NSBC). Gli studenti delle Facoltà di Medicina svolgono il tirocinio presso queste strutture.

Poliambulanca "Atë Luigji Monti", struktura e parë e themeluar nga Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë, vepron në Shqipëri prej më shumë se 20 vitesh dhe ofron shërbim të kualifikuar diagnostikimi dhe terapie. Pozicionuar në qendër të qytetit dhe e ristrukturuar së fundmi, ka një staf mjekësh të kualifikuar në specialitete të ndryshme si: Mjekësi e Brendshme, Kardiologji, Onkologji, Gjinekologji, Okulistikë, Dermatologji, Pediatri, Ortopedi, Nefrologji, Kirurgji digjestive etj.



Sëbashku me laboratorin bashkëkohor të analizave, sektorin e diagnostikimit me imazhe dhe Farmacinë IDI-al, Poliambulanca përfaqëson një ndër ekselencat e sektorit. Listës së shërbimeve i është shtuar së fundmi shërbimi i ndërhyrjeve kirurgjikale ditore – Day Surgery. Poliambulanca është e lidhur me Klinikën Stomatologjike dhe me Klinikën e Fizioterapisë (të vendosura në ambientet e kampusit të Universitetit Katolik ZKM). Shumë studentë të Fakuktetit të Mjekësisë kryejnë praktikën mësimore pranë këtyre strukturave.

# TAKE A BREAK

*Combattere lo stress con il cibo* // *Si të luftosh stresin përmes ushqimit*



L'università può essere un'esperienza bella ma stressante. Per molti studenti, soprattutto per quelli che vivono lontano dalla loro famiglia, tutto è diverso: il cibo, le persone e gli alloggi. Ricordiamo che anche i cambiamenti positivi possono indurre stress. Quali sono i cibi migliori e quelli peggiori da mangiare quando si è stressati?

Alimenti :

1. Calcio: latte di mandorle, spinaci, yogurt, broccoli, cavoli, e fichi
2. Vitamine del complesso B: mandorle, arance, banane, fiocchi d'avena, avocado e asparagi
3. Vitamina D: luce solare
4. Magnesio: spinaci, banane, noci, semi di zucca e cioccolato fondente
5. Vitamina C: arance, mirtilli, limoni e lime
6. Acidi grassi Omega-3: noci, salmone e tonno

Alimenti :

1. Alimenti trasformati
2. Prodotti a base di farina bianca
3. Alcool
4. Eccessiva caffeina
5. Zucchero

***Da un articolo scientifico della Prof.ssa Angela Andreoli, Medico-nutrizionista, Docente presso l'Università Cattolica NSBC***

Universiteti mund të jetë një eksperiencë sa e bukur, aq edhe stresuese. Për shumë studentë, gjithçka ndryshon: ushqimi, njerëzit dhe vendbanimi, sidomos për ata që studiojnë dhe jetojnë larg shtëpisë. Shpeshherë edhe ndryshimet pozitive mund të jenë arsye stresi. Por, cilat janë ushqimet e rekomanduara dhe ato të cilat duhen shmangur?

Ushqimet :

1. Kalcium: qumësht bajame, spinaq, kos, brokoli, lakra dhe fiq
2. Vitaminë B kompleks: bajame, portokall, banane, thekër, avokado dhe asparag
3. Vitaminë D: drita e diellit
4. Magnezi: spinaqi, banane, arra, fara kungulli dhe çokollata e errët
5. Vitaminë C: portokall, boronicë, limon dhe lime
6. Acidet yndyrore Omega-3: arra, salmon dhe ton

Ushqimet :

1. Ushqime të përpunuara
2. Produkte me bazë miellin e bardhë
3. Alkooli
4. Kafeina e tepruar
5. Sheqeri

***Nga një artikull shkencor i Prof. Angela Andreoli-t, Mjeke nutricioniste, Pedagoge pranë Universitetit Katolik ZKM***

Ricordo ancora oggi il sapore della felicità quando ebbi la notizia di avere superato il test, ma anche la perplessità che scaturiva dal dover lasciare l'Italia per iniziare a vivere in Albania, terra e popolazione che era nella mia mente vista con i consueti stereotipi triti e ritriti nella penisola italiana. Il più grande pregiudizio era legato al rischio derivante dal confronto di due culture apparentemente lontane con relative conseguenze sui rapporti interpersonali. Ed è con vero stupore che ho scoperto persone amichevoli e rispettose ed ho visto negli anni nascere amicizie e anche amori, ho visto ragazzi italiani piangere di commozione tra le braccia di amici albanesi quando era giunto il momento di rientrare definitivamente in Italia.
Quasi a termine di una delle esperienze più belle della mia vita, sono certo che l'Albania e quest'università rimarranno un punto di riferimento per una continua crescita sociale e professionale.

**Una testimonianza di Giuseppe Russo, studente di Odontoiatria e rappresentante degli studenti**




Ende sot, kujtoj ndjesinë e lumtur kur mora lajmin se kisha kaluar testimin hyrës, por edhe skepticizmin e lidhur me faktin që duhet të largohesha nga Italia për të jetuar në Shqipëri, tokë dhe popull që i imagjinoja sipas stereotipeve të zakonshëm të krijuar në gadishullin italian. Paragjykimi më i madh lidhej me rrezikun e përballjes së dy kulturave, të largëta në pamje të parë, si dhe me pasoja të pashmangshme në marrëdhënie ndërpersonale.
Për habi, zbulova njerëz miqësorë dhe të respektueshëm dhe përgjatë viteve kam parë të lindin miqësi dhe dashuri, kam parë të rinjtë italianë të mallëngjehen në krahët e miqve shqiptarë në çastin e përshëndetjeve përpara se të ktheheshin përfundimisht në Itali.
Pothuajse në përfundim të përvojës më të bukur të jetës time, jam i sigurt se Shqipëria dhe ky universitet do të vazhdojnë të jenë pikë referimi për mua, në rritjen sociale dhe profesionale.

**Një rrëfim nga Giuseppe Russo, student i Odontoiatrisë dhe përfaqësues i studentëve**

# Prospectus



***"La musica è l'architettura liquida e l'architettura è la musica congelata."***
*Goethe*

Musica ed architettura: nate dal bisogno di esprimersi prendono forma da regole basate sulla matematica e sulla geometria.
Due arti, un'unica perpetua ricerca dell'armonia!
Un'unica parola, architettura e all'interno tanti stili, dinamiche, colori, luci ed ombre, tanti modi e momenti diversi per viverla, così come nella musica. E come la musica, l'architettura è un idea che metti su carta, non la "scrivi" e basta, ma costantemente la sovrascrivi.
È difficile descrivere a parole cos'è l'architettura, come non puoi sempre spiegare le sensazioni che ti dà la musica.
Non devi parlare d'architettura, la devi creare, percepire, vivere!

**STUDIATE ARCHITETTURA, REGALATE MELODIA ALLA VOSTRA VITA!**

***"Muzika është arkitekturë e rrjedhshme dhe arkitektura është muzikë e ngurtë."***
*Goethe*

Muzika dhe arkitektura: të lindura nga nevoja për t'u shprehur, marrin formë nga rregulla matematikore dhe gjeometrike.
Dy forma arti, i njëjti kërkim i pashtershëm drejt harmonisë!
Një fjalë e vetme, arkitekturë dhe brenda saj shumë stile, dinamikë, ngjyrë, dritëhije, mënyra dhe momente të ndryshme për ta përjetuar, ashtu si edhe muzika.
Dhe njësoj si muzika, arkitektura është një "ide" që hidhet në letër për tu rishkruar me pas. Është e veshtirë të përshkruhet me fjalë çfarë është arkitektura, ashtu si jo gjithmonë mund të shpjegohen emocionet që të përcjell muzika.
Arkitekturën nuk mund ta rrëfesh, duhet ta krijosh, perceptosh e jetosh!

**STUDIONI ARKITEKTURË, SHTOJINI JETËS TUAJ MELODI!**




## ERNESTO ALICICCO, IL PROFESSORE DALLE MANI D'ORO

Questo è il nome che tutti dicono nell'Università Cattolica NSBC, quando si cerca di sapere di più in materia di fisioterapia.
Certo, all'inizio pensi di incontrare un medico con tanta esperienza, ma quando incontri da vicino il prof. Alicicco, ti vedi aprire davanti un mondo nuovo, sconosciuto.
Laureato in chimica farmaceutica, medicina, specializzato in fisiatria, endocrinologia, in medicina sportiva e traumatologia, il Prof. Alicicco è oggi responsabile del Centro di Riabilitazione e Medicina dello Sport.
"UCNSBC diventerà una delle più grandi università dei Balcani, - dice il Prof. Ernesto Alicicco, - specialmente dopo la costruzione del nuovo ospedale universitario."
Oltre all'insegnamento, Alicicco segue da vicino tutti i pazienti sin dalla prima visita medica, e durante il trattamento terapeutico di riabilitazione e idrochinesiterapia.
Il professore è anche noto per il suo amore per lo sport, specialmente per il calcio. La maggior parte della sua carriera l'ha trascorsa come medico ufficiale dell' A.S. Roma in Italia, dal 1978 al 2002.

## ERNESTO ALICICCO, PROFESORI ME DUAR TË ARTA

Ky është emri që të përmendin të gjithë në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", kur kërkon të njohësh më tepër rreth fizioterapisë. Natyrisht, në fillim mendon se thjeshtë do të takosh një mjek me shumë eksperiencë, por kur e takon nga afër profesor Alicicco-n, të hapet një botë krejt e re, e panjohur.
I diplomuar në kimi - farmaci, mjekësi, i specializuar në fiziatri, endokrinologji, në mjekësi sportive dhe traumatologji, Prof. Alicicco është sot Përgjegjësi i Qendrës së Rehabilitimit dhe Mjekësisë Sportive.
"UKZKM do të bëhet një nga universitetet më të mëdha të Ballkanit - thotë prof. Ernesto Alicicco, – sidomos me ndërtimin e spitalit të ri në kampus."
Përveç mësimdhënies, Alicicco ndjek nga afër edhe pacientët, që nga vizita mjekësore e deri tek terapia fizike, rehabilitimi dhe hidrokinezoterapia.
Profesori është i famshëm edhe për dashurinë e tij ndaj sportit, sidomos ndaj futbollit. Pjesën më të madhe të karrierës së tij e ka kaluar si mjek zyrtar i klubit të "A.S Roma" në Itali, nga 1978 deri në vitin 2002.



# Conoscete i Presidi // Njihuni me Dekanët



**Prof. Giovanni Arcudi**, Preside della Facoltà di Medicina.
È professore di Medicina Legale presso l'Università di Tor Vergata di Roma, Italia. È autore di un noto trattato di "Medicina legale", e di numerose pubblicazioni scientifiche.



**Prof. Giovanni Lagioia**, Preside della Facoltà di Scienze Economiche, Politiche e Sociali e Direttore del Dipartimento di Economia, Management e Diritto dell'Impresa all'Università di Bari. Autore di diversi libri come "Il ruolo dei biocombustibili negli scenari energetici", e di una vasta serie di pubblicazioni.



**Prof. Carlo De Giuli Morghen**, Preside della Facoltà di Farmacia. Membro di diverse società scientifiche internazionali, coautore del libro "Avian RNA Tumor Viruses" e di molte pubblicazioni scientifiche.



**Prof. Ulisse Tramonti,** Presidente del CdL in Architettura. Autore di molti libri, promotore e relatore di diverse conferenze, curatore di mostre, e vincitore di importanti concorsi internazionali per le progettazioni architettoniche e urbane.

**Prof. Giovanni Arcudi**, Dekan i Fakultetit të Mjekësisë.
Është pedagog i Mjekësisë Ligjore në Universitetin Tor Vergata të Romës në Itali.
Është autor i manualit "Mjekësia ligjore", si edhe i publikimeve të shumta shkencore sektoriale.

**Prof. Giovanni Lagioia**, Dekan i Fakultetit të Ekonomisë dhe Drejtor i Departamentit të Ekonomisë, Menaxhimit dhe të së Drejtës së Sipërmarrjes në Universitetin e Barit. Autor i disa librave si "Il ruolo dei biocombustibili negli scenari energetici", si dhe i një sërë publikimesh shkencore.

**Prof. Carlo De Giuli Morghen**, Dekani i Fakultetit të Farmacisë. Mban titullin Doktor i shkencave biologjike. Anëtar i disa shoqatave shkencore ndërkombëtare, bashkëautor i librit "Avian RNA Tumor Viruses" dhe i publikimeve të shumta shkencore.

**Prof. Ulisse Tramonti**, Drejtues i Programit të Studimit në Arkitekturë.
Autor i disa botimeve, promotor dhe relator i konferencave të shumta, kurator ekspozitash, si edhe fitues i konkurseve të rëndësishme ndërkombëtare mbi projektimin arkitektonik dhe urban.

# Intervista con il Presidente della Fondazione NSBC// Intervistë e Presidentit të Fondacionit ZKM




**Qual è la sua più grande soddisfazione in questi anni da Presidente della Fondazione?**

Quando nel 2011 mi fu chiesto di assumere la presidenza della Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio, pur non sapendo esattamente che cosa avrebbe comportato, ho accolto la richiesta con grande entusiasmo. Appena arrivato, ho cercato di analizzare, con l'aiuto di padre Jerome, la realtà in cui dovevo operare e porre dei traguardi. Tra questi, creare un ambiente più accogliente per gli studenti era una priorità. Da qui, abbiamo costruito nuove aule, nuovi laboratori, predisposto una nuova biblioteca e creato nuovi spazi di studio e ludici negli spazi verdi. Abbiamo dimostrato agli studenti, e non solo, come anche in Albania sia possibile creare istituzioni serie, capaci di crescere, economicamente sane, senza tralasciare il dovere della trasparenza e dell'onestà. Desidero inoltre realizzare la promessa della congregazione religiosa cui appartengo, di costruire un ospedale in cui l'ammalato sia veramente il centro dell'azione clinica.

**Si President i Fondacionit, a mund të na rendisni disa prej arritjeve për të cilat krenoheni?**

Në vitin 2011, kur më kërkuan që të drejtoj Fondacionin Zoja e Këshillit të Mirë, pranova me entuziazëm duke mos ditur me saktësi se çfarë më priste. Sapo mbërrita, u përpoqa të analizoja me ndihmën e Atë Jerome, realitetin ku do të veproja dhe të caktoja disa objektiva. Midis këtyre, krijimi i një mjedisi më të ngrohtë për studentët ishte përparësi. Ja pse ndërtuam klasa të reja, laboratorë të rinj, bibliotekë të re dhe krijuam hapësira studimi e çlodhjeje në ambientet e gjelbëruara. I treguam studentëve, dhe jo vetëm, që edhe në Shqipëri mund të krijohen institucione serioze me kapacitet në rritje, ekonomikisht të shëndetshëm, pa anashkaluar detyrimin për transparencë dhe ndershmëri. Mbi të gjitha dua të mbaj premtimin e kongregatës të cilës i përkas: ndërtimi i një spitali, ku i sëmuri është me të vërtetë në qendër të vëmendjes klinike.

**Quali sono i progetti futuri della Fondazione?**

L'università è un cosmo che, parafrasando una affermazione di Sant'Agostino, cerca la verità e continua a cercarla dopo averla trovata. Per svolgere la sua azione accademica l'università necessita di strumenti. In particolare, la facoltà di medicina necessita di un ospedale. Per questo il mio lavoro principale, al di là della quotidianità, in questi due anni è stato riniziare il progetto della costruzione dell'ospedale a servizio della comunità albanese, dei docenti e degli studenti per realizzare la missione accademica. La nuova struttura, che nella prima fase prevede la preparazione di 40 posti letto, ambulatori e un servizio completo di diagnostica, presenterà delle eccellenze quali l'ortopedia, l'oculistica, la chirurgia generale e, particolarmente, la senologia e ginecologia oncologica. Il progetto sanitario è stato preparato con la collaborazione dell'Ospedale Poliambulanza di Brescia, un'eccellenza in campo nazionale italiano.




**Cilat janë projektet e ardhshme të Fondacionit?**

Duke cituar Shën Agostinin, universiteti është një kozmos që kërkon të vërtetën dhe vazhdon ta kërkojë atë, edhe pasi e ka gjetur. Për të zhvilluar veprimtarinë akademike universiteti ka nevojë për instrumente. Në veçanti, fakulteti i mjekësisë ka nevojë për një strukturë spitalore. Prandaj, impenjimi im kryesor në këto dy vite, përtej përditshmërisë, ka qenë rifillimi i projektit për ndërtimin e spitalit në shërbim të komunitetit shqiptar, si dhe të pedagogëve e studentëve për realizimin e misionit akademik. Fillimisht, spitali do të pajiset me 40 shtretër, ambulatorë dhe një shërbim të plotë diagnostikimi, si dhe do të krenohet me ekselencën në ortopedi, okulistikë, kirurgji të përgjithshme dhe në veçanti, në fushën senologjike dhe gjinekologji- onkologjike. Projekti shëndetësor është përgatitur në bashkëpunim me Institutin Spitalor të Breshia-s, ndër më të mirët në Itali.

# Gli appuntamenti da non perdere del mercoledì // Takimet e së mërkurës që nuk duhet të humbisni

## SEMINARI INTERDISCIPLINARI DEL MERCOLEDÌ UKZKM

Promosso dal Magnifico Rettore, viene attivato all'Università Cattolica un Ciclo di Seminari Interdisciplinari. Questa serie di eventi si propone di discutere argomenti di attualità, extracurriculari, che spaziano dalle novità in campo farmacoterapeutico fino agli effetti delle spese militari sullo sviluppo economico.
Ideatori di quest'iniziativa sono il Prof. Bruno Zappacosta e il Prof. Francesco Rulli, rispettivamente direttore del Dipartimento per la Valutazione Chimico-Tossicologica e Farmacologica dei Farmaci della Facoltà di Farmacia e Direttore del Dipartimento di Scienze Chirurgiche della Facoltà di Medicina. Questi seminari, quindi abbracciano diverse discipline, dipartimenti e facoltà (l'agenda è consultabile in pagina 19).
I relatori designati, oltre a presentare i risultati dei loro studi scientifici, si confronteranno attivamente con gli studenti. Il ciclo di seminari verrà attuato lungo tutto l'anno accademico ed è aperto a professionisti di riconosciuta esperienza, che operano dentro e fuori il campus.

## SEMINARËT NDËRDISIPLINORË E SË MËRKURËS UKZKM

Me mbështetjen e Rektorit, vjen në Universitetin Katolik Cikli i Seminarëve Ndërdisiplinorë. Kjo seri eventesh ka për qëllim të sjellë për diskutim tema interesante dhe çështje të rendit të ditës, ekstrakurrikulare, të cilat variojnë që nga risitë në fushën farmakoterapeutike e deri tek pesha e shpenzimeve ushtarake në zhvillimin ekonomik.
Ideatorë të kësaj nisme janë Prof. Bruno Zappacosta dhe Prof. Francesco Rulli, përkatësisht drejtor i Departamentit për Vlerësimin Kimik - Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave të Fakultetit të Farmacisë dhe drejtor i Departamentit të Shkencave Kirurgjikale të Fakultetit të Mjekësisë. Këta seminarë përfshijnë disiplina, departamente dhe fakultete të ndryshme (kalendarin e eventeve e gjeni në faqen 19).
Relatorët, përveç paraqitjes së studimeve të tyre shkencore, kanë për qëllim të nxisin studentët të marrin pjesë në diskutim.
Cikli i Seminarëve Ndërdisiplinorë do të shtrihet përgjatë gjithë vitit akademik dhe pjesëmarrja është e hapur për profesionistët e fushave të ndryshme, brenda dhe jashtë kampusit universitar.

Seminari Interdisciplinari del mercoledì UKZKM



# Fatti e persone //
# Ngjarje dhe personazhe




"UCNSBC porta il cambiamento nella cultura, così come il Comune di Tirana sta facendo cabiamenti nell'infrastruttura".

*Erjon Veliaj, Sindaco di Tirana*
*Convegno "Essere città oggi", UCNSBC*

"UKZKM sjell ndryshim në kulturë, ashtu si Bashkia e Tiranës po bën ndryshimin e infrastrukturës".

*Erjon Veliaj, Kryetar i Bashkisë së Tiranës*
*Konferenca "Të jesh qytet sot", UKZKM*

"Ringraziandovi dell'invito e per questa meravigliosa e significativa organizzazione, vi prego di accettare i miei migliori complimenti per l'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio", che visito per la prima volta ma per la quale ho sentito solo pareri positivi.
Congratulazioni!"

*Ilir Meta, Presidente della Repubblica dell'Albania*
*Conferenza "Migranti e rifugiati: uomini e donne in cerca di pace", UCNSBC*

"Duke ju falenderuar për ftesën, dhe për këtë organizim të mrekullueshëm dhe plot kuptim, njëkohësisht pranoni ju lutem dhe komplimentet e mia më të mira për Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", ku vijë për herë të parë, por për të cilin kam dëgjuar aq fjalë të mira. Suksese!"

*Ilir Meta, President i Republikës së Shqipërisë*
*Konferenca "Emigrantë dhe refugjatë: burra dhe gra në kërkim të paqes", UKZKM*



# STAGE



**Alba Shijaku**
**Studentessa, Facoltà di Economia //Studente, Fakulteti i Ekonomisë**

Mi è stata offerta l'opportunità di svolgere il tirocinio formativo presso una delle più grandi aziende a livello mondiale che offre servizi di revisione di bilancio, consulenza legale e fiscale: la PriceWaterhouseCoopers (PWC). Grazie a quest'esperienza ho potuto vedere come funziona una società di servizi e ho compreso la reale importanza del teamworking. Non fatevi sfuggire la possibilità di uno stage utile alla vostra crescita professionale.

Praktikën mësimorë pata mundësinë ta zhvilloj pranë një prej kompanive më të mëdha botërore që ofron shërbime auditi, konsulencë ligjore dhe fiskale: PriceWaterhouse Coopers (PWC). Falë kësaj eksperience pashë se si funksion një shoqëri që ofron shërbime dhe kuptova rëndësinë e vërtetë të punës në grup. Mos humbisni mundësinë e një stazhi të rëndësishëm për rritjen tuaj profesionale.



**Eneida Çela**
**Studentessa, Facoltà di Medicina //Studente, Fakulteti i Mjekësisë**

Il tirocinio al Policlinico Tor Vergata è stata un'esperienza Unica! Frequentando i reparti ho confermato la mia passione e dedizione per la Medicina. Il tirocinio mi ha dato la possibilità di mettere in pratica ed ampliare le conoscenze acquisite durante il percorso accademico all'UCNSBC, seguendo tecniche europee e innovative. È stato un importante arricchimento dal punto di vista medico, ma anche culturale ed è un'esperienza che consiglierei a tutti!

Stazhi në Poliklinikën Tor Vergata të Romës ishte një përvojë unikale! Jeta në repartin e kësaj klinike, më konfirmoi pasionin dhe përkushtimin tim ndaj mjekësisë. Përmes teknikave të reja dhe europiane, stazhi më dha mundësinë të praktikoja dhe të zgjeroja njohuritë e fituara gjatë rrugëtimit tim në UKZKM. Kjo përvojë shërbeu për të më pasuruar si në pikëpamjen mjekësore, ashtu edhe në atë kulturore.
Do ja këshilloja të gjithëve!

## 06 18

**20**
giugno // qershor
Seminari Interdisciplinari del mercoledì UKZKM
Campus universitario: una riflessione sull'uomo
Kampusi Universitar: reflektim mbi njeriun

**01-02**
giugno // qershor
The 2nd International Symposium of Orthodontics

## 05 18

maggio// maj
Lezione Aperta di Architettura
Ciclo di Lezioni di Architettura
Cikël Leksionesh mbi Arkitekturën

**23**
maggio // maj
Seminari Interdisciplinari del mercoledì UKZKM
L'epidimiologia dell'HCV in Albania
Epidemiologjia e HCV në Shqipëri

**19**
maggio // maj
UNIVERSITETI I HAPUR 2018
Universiteti i Hapur 2018
OPEN DAY 2018

## 04 18

**26**
aprile // prill
Festa della Fondazione
Festa e Fondacionit
FONDACIONI ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

**20-22**
aprile // prill - FMD
Convegno delle Scienze Mediche V
Konferenca e Shkencave Mjekësore V

**18**
aprile // prill
Seminari Interdisciplinari del mercoledì UKZKM
Genesi del Diritto Parlamentare comparato italo-albanese

**14**
aprile // prill
UNIVERSITETI I HAPUR 2018
Universiteti i Hapur 2018 - UKZKM
OPEN DAY 2018 - UCNSBC

**11**
aprile // prill
Seminari Interdisciplinari del mercoledì UKZKM
Il fardello delle spese militari sullo sviluppo economico tra instabilità, corruzione e disuguaglianze
Pesha e shpenzimeve ushtarake në zhvillimin ekonomik, në kushte paqëndrueshmërie, korrupsioni dhe pabarazie

**6-7**
aprile // prill
2nd Edition, Mediterranean TourismFair Tirana 2018

## 03 18

**28-29**
marzo // mars
Work & Study

**23-24**
marzo // mars
Studiare in Italia
Studime në Itali

Italian Design Day
marzo// mars
Italian Design Day 2018

**14**
marzo // mars
Festa di Primavera
Dita e Verës

**13**
marzo // mars
Seminari Interdisciplinari del mercoledì UKZKM
Medicina dei migranti
Mjekësia e migrantëve

# Squadra di calcio dell'Università// Skuadra e futbollit e Universitetit

# UKZKM




*E. Kamberi, Xh. Ibraj, G. Veronico, C. Sirianni, A. Salla, E. Fero, S. Elmadhi, G. Erroi, E. Shahini, A. Hasani, L. La Camera, L. Caviziel, R. Stefan, S. Brati, R. Ramadani, D. Terraciano, A. Meminaj, A. Zaccar-ia, N. Papetti, R. Kraja, M. Guarino, B. Berisha,*

Allenatori // Trajnerët

**E. Bacaj , M. Dervishaj, E. Kushta**

# Linking Words



### LA PASTORALE UNIVERSITARIA UCNSBC

L'università è una antica istituzione sociale che continua a rinnovarsi e adattarsi alle nuove sfide che la società impone.
L'Università è anche un luogo di incontro, di scambio di idee, di arricchimento reciproco e di crescita. Ed è per questo che dentro la nostra istituzione troverete il servizio della pastorale universitaria, il luogo dove incontrarsi con amici, il luogo di apertura e accettazione, la seconda casa degli studenti.
La pastorale universitaria si offre come strumento di accompagnamento nella ricerca, per promuovere attraverso il discernimento dei valori, la tutela della cultura della vita.
La Pastorale universitaria è impegnata anche in opere di beneficienza e in diverse attività sociali.

### BARITORJA UNIVERSITARE UKZKM

Universiteti është një institucion i lashtë shoqëror, i cili që nga lashtësia vijon të rinovohet dhe të përshtatet me ndryshimet dhe sfidat e reja të shoqërisë. Universiteti është edhe një vendtakim, vend për të shkëmbyer idetë, vend për pasurimin dhe rritjen e ndërsjelltë.
Për këtë arsye, brenda universitetit tonë është krijuar Baritorja, vendtakimi i studentëve, shtëpia e tyre e dytë, e hapur për të gjithë. Baritorja universitare vjen si një instrument që përcjell vlerat kulturore dhe ato të jetës.
Baritorja universitare është e angazhuar edhe në vepra bamirësie dhe në aktivitete të ndryshme shoqërore.



# HABITAT



**Dario:** Consiglio ai futuri medici di fare un'esperienza forte prima della laurea, in una terra lontana e con una realtà diversa dalla nostra, dove l'ingiustizia e la sofferenza scavalcano confini impensabili. Io, personalmente, sono stato in Africa. Se il desiderio di diventare medico resiste a questa prova, significa che si sta percorrendo la strada giusta.

**Dario:** U këshilloj mjekëve të ardhshëm të provojnë një eksperiencë të fortë para diplomimit, në një vend të largët dhe me një realitet ndryshe nga i yni, një vend ku padrejtësia dhe vuajtja kapërcejnë kufij të paimagjinueshëm, siç ishte Afrika për mua. Nëse dëshira për t'u bërë mjek i reziston kësaj sprove, keni ndërmarrë rrugën e duhur.



**Stela:** Io sono nata a Berat ma non sono di parte se vi consiglio una gita fuori porta nella città bimillenaria Patrimonio UNESCO.
Rimarrete affascinati. Se siete sportivi e coraggiosi, non perdetevi la possibilità di fare rafting nei canyon del fiume di Berat, Osum.

**Stela:** Unë kam lindur në Berat, por nuk jam e njëanshme nëse ju këshilloj një ekskursion në qytetin mbi dymijë vjeçar të mbrojtur nga UNESCO. Do të mbeteni të mahnitur. Nëse jeni sportivë dhe kurajozë, mos humbisni edhe mundësinë për të bërë rafting në kanionet e lumit të Beratit, Osumit.



**Elisa:** Prendete la bici e fate un giro nella vicina montagna di Dajti, godetevi la discesa verso Tirana. Sentirete l'aria fresca che vi accarezza la pelle, vedrete ogni colore che madre natura ha creato, ascolterete lo scrosciare dei ruscelli e respirerete l'aria pura.
Il percorso dura circa un'oretta, tutti lo possono fare!

**Elisa:** Merrni biçikletën dhe bëni një xhiro në malin e afërt të Dajtit, shijoni tatëpjetën drejt Tiranës. Do të ndjeni ajrin e freskët që ju përkëdhel, do të shikoni çdo ngjyrë të krijuar nga natyra, do të dëgjoni zhurmën e përrenjëve dhe do të thithni ajrin e pastër.
Udhëtimi zgjat gati një orë, të gjithë mund të shkojnë!

# PIANO DELLA FORMAZIONE // PLAN FORMIMI

## I° CICLO // CIKLI I PARË

## II° CICLO // CIKLI I DYTË

## III° CICLO // CIKLI I TRETË

### LAUREA MAGISTRALE A CICLO UNICO // PROGRAM I INTEGRUAR CIKËL UNIK

- MEDICINA E CHIRURGIA *(ciclo unico 6 anni)*
  MJEKËSI *(cikël i integruar 6 vjeçar)*
- ODONTOIATRIA E PROTESI DENTARIA *(ciclo unico 6 anni)*
  ODONTOIATRI DHE PROTEZË DENTARE *(cikël i integruar 6 vjeçar)*
- FARMACIA *(ciclo unico 5 anni)*
  FARMACI *(cikël i integruar 5 vjeçar)*
- ARCHITETTURA *(ciclo unico 5 anni)*
  ARKITEKTURË *(cikël i integruar 5 vjeçar)*

### LAUREA TRIENNALE / BACHELOR

- INFERMIERISTICA / INFERMIERISTIKË
- FISIOTERAPIA / FIZIOTERAPI
- ECONOMIA AZIENDALE / EKONOMI NDËRMARRJEJE
- SCIENZE POLITICHE / SHKENCA POLITIKE
- INGEGNERIA CEA / INXHINIERI NDËRTIMI E MJEDISI

### LAUREA MAGISTRALE / MASTER I SHKENCAVE

LAUREA MAGISTRALE / MASTER SHKENCOR

- SCIENZE INFERMIERISTICHE E OSTETRICHE / SHKENCAT INFERMIERISTIKE DHE OBSTETRIKE
- SCIENZE RIABILITATIVE DELLE PROFESSIONI SANITARIE / SHKENCAT REHABILTUESE TË PROFESIONEVE SHËNDETËSORE
- ECONOMIA E MANAGEMENT / EKONOMI DHE MENAXHIM
- RELAZIONI INTERNAZIONALI: STUDI EUROPEI / MARREDHENIE NDERKOMBETARE: STUDIME EUROPIANE

### III° CICLO

- SPECIALIZZAZIONE A LUNGO TERMINE DELL'AREA MEDICA // SPECIALIZIME AFATGJATË NË FUSHËN E MJEKSISË

MASTER DI II° LIVELLO / MASTER EKZEKUTIV

- IMPLANTOLOGIA E PROTESI DENTARIA / IMPLANTOLOGJI DHE PROTEZË DENTARE
- ORTOGNATODONZIA / ORTODONCI

- DOTTORATO DI RICERCA IN STATISTICA / DOKTORATË NË STATISTIKË
- DOTTORATO DI RICERCA IN SANITÀ PUBBLICA / DOKTORATË NË SHËNDET PUBLIK

| ANNI / VITE | | |
|---|---|---|
| I° ciclo | II° ciclo | III° ciclo |
| 1 2 3 | 4 5 6 | 1 2 3 4 5 |




**Kompleksi Spitalor Universitar**
"Zoja e Këshillit të Mirë"

Rruga Dritan Hoxha, Tiranë

**web** https://www.unizkm.al/

**tel.** 00355 4 2273290

**email** info@unizkm.al

**facebook** unikzkm

**you tube** unikzkm

**instagram** unikzkm

**twitter** unikzkm